



Energy Regulatory Office  
Zyra e Rregullatorit për Energji  
Regulatorni Ured za Energiju

Hamdi Mramori Street, No 1

Prishtina 10000 – Kosovo

Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103

Fax: +381 (0) 38 247 620

e-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org)

[www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

# Zyra e Rregullatorit për Energji Udhëzimet për Aplikimin për Tarifa

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Dispozitat e përgjithshme</b>	<b>1</b>
1.1	Shtrirja dhe qëllimi	1
1.2	Amandamentet	2
1.3	Definimet dhe interpretimet	2
<b>2</b>	<b>Përgatitja dhe dorëzimi i aplikacioneve për tarifat e rregulluara</b>	<b>4</b>

# 1 Dispozitat e përgjithshme

## 1.1 Shtrirja dhe qëllimi

- 1.1.1 Këto Udhëzime të Aplikimit për Tarifa janë nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me qëllim të krijimit të formës për dorëzimin e aplikimeve të tarifave të rregulluara të propozuara nga i licencuari për rishikim dhe aprovim nga ZRRE-ja.
- 1.1.2 Nga të licencuarit kërkohet që çdo vit të dorëzojnë ZRRE-së propozimet për **tarifat e rregulluara** për vitin pasues në pajtim me procedurat e dhëna në Rregulloren mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë ( "Rregullorja mbi Çmimet").
- 1.1.3 Neni 8 i Rregullores mbi Çmimet kërkon, pjesërisht, që:
- 8.7 Kur dorëzohet propozimi për tarifa, secila ndërmarrje energjetike [i licencuar] do të dorëzojë një justifikim për tarifat e propozuara përfshirë, së paku:
- a) Programin për tarifat e propozuara bashkë me datën e propozuar të efektivitetit;
  - b) Sasitë ekzistuese të furnizuara apo të transportuara, si të jetë më e përshtatshme, për çdo kategori konsumatorësh për 12 muajt e mëparshëm;
  - c) Aplikimi i tarifave aktuale për secilën kategori konsumatorësh;
  - d) Informata tjera që ndërmarrja energjetike i konsideron se mund të mbështesin aplikimin e saj për aprovim të tarifave të propozuara.
- 8.8 Kur një ndërmarrje energjetike rregullohet sipas tarifave të bazuara në performancë, ajo duhet të dorëzojë prova që demonstrojnë përputhshmërinë e tarifave të veta të propozuara me vendimin më të fundit në lidhje me kontrollin e çmimit për ndërmarrjen në fjalë, duke marrë parasysh rregullimet brenda periudhës së caktuar.
- 8.9 Kur një ndërmarrje nuk rregullohet sipas tarifave të bazuara në performancë, duhet të paraqesë prova të kostos së saj për 12 muajt e paraprakë dhe kostot e parashikuara për 12 muajt vijues, në formatin e specifikuar nga ZRRE-ja në Udhëzimet Rregullatore të Kontabilitetit. Ndërmarrja energjetike duhet të dorëzojë informata shtesë të cilat justifikojnë çdo ndryshim midis kostove aktuale dhe atyre të parashikuara, ashtu siç e konsideron më të arsyeshme.
- 1.1.4 Neni 10 i Rregullës mbi Çmimet kërkon që:
- 10.1 Kur një ndërmarrje energjetike kërkon modifikim të një kategorie tarife ose komponentë tarifore, si pjesë e dorëzimit të tarifës në përputhje me Nenin 7, atëherë duhet të dorëzojë edhe:
- a) Vlerësime të numrit të konsumatorëve dhe sasive të furnizuara ose transportuara, që mund të kenë qenë ngarkuar për çdo kategori tarife dhe komponent tarife, nëse ndryshimi i propozuar në këto më të fundit ka qenë në fuqi për më shumë se 12 muajt e fundit;

- b) Vlerësimet e të ardhurave vjetore që mund të kenë qenë fituar sipas çdo kategorie tarifore dhe komponentë tarifore, në rast se ndryshimi i propozuar në kategoritë tarifore ose ndryshimit të komponentëve tarifore ka qenë në fuqi për më shumë se 12 muajt e fundit;
- c) Vlerësimet e numrit të konsumatorëve dhe sasive të furnizuara ose transportuara, që do të ngarkohen nën secilën kategori tarifore dhe komponentë tarifore për 12 muajt e ardhshëm, nëse ndryshimi i propozuar në kategori tarifore ose modifikimi i komponentëve tariforë është aprovuar;
- d) Vlerësimet e të ardhurave vjetore që do të fitohen sipas secilës kategori tarifore dhe komponentë tarifore për 12 muajt e ardhshëm, nëse ndryshimi i propozuar në kategoritë tarifore ose ndryshimet në komponentët tariforë, aprovohet;
- e) Detajet dhe bazat për vlerësime të tilla.

1.1.5 Këto Udhëzime tregojnë formën e aplikimit për tarifën e rregulluar që do t'i përdorë i licencuari, duke u pajtuar me kërkesat e nenit 8.7 dhe 10.1 të Rregullores së Çmimeve. Ndarazi, i licencuari gjithashtu do të demonstrojë pajtimin me kërkesat e nenit 8.8 në pajtim me vendimin relevant, ose 8.9 duke përdorur formën e përdorur në shumicën e Udhëzimeve Rregullatore për Kontabilitetin të nxjerra nga ZRRE-ja.

## 1.2 Amandamentet (ndryshimet)

1.2.1 ZRRE-ja do të ndryshojë këto Udhëzime herë pas here sipas nevojës. Kur bëhen këto ndryshime, ZRRE-ja do të ofrojë mundësitë e duhura për konsultim me të licencuarin dhe palët tjera të interesuara, duke përfshirë, në përgjithësi:

- Publikimin e njoftimit të synimit të ZRRE-së që të ndryshojë këto Udhëzime;
- Futjen e të dhënave, përfshirë formën e komenteve me shkrim dhe konsultimet me të licencuarin dhe palët e interesuara, dhe lejimin e një kohe të arsyeshme për përgatitjen e këtyre të dhënave;
- Përgatitjen dhe publikimin për komente të draftit për amendamentet e propozuara, duke marrë parasysh të dhënat e pranuar; dhe
- duke marrë parasysh komentet e pranuar në finalizimin e amendamenteve.

## 1.3 Definimet dhe interpretimet

1.3.1 Termat në vijim të përdorur në këto Udhëzime do të kenë këtë kuptim:

- **“Tarifat e rregulluara të ndryshuara”** është një tarifë e rregulluar e ndryshuar që përfshin, por nuk kufizon, baza të reja të detyrimit, kategori të re konsumatorësh ose një detyrim të ri;
- **“Tarifa e rregulluara ekzistuese”** nënkupton strukturat tarifore, kategoritë dhe bazat e detyrimit aktualisht në fuqi;

- “**Udhëzimet**” janë këto Udhëzime të Aplikimit për Tarifa;
- “**Rregulla e Çmimeve**” është Rregulli mbi Parimet e Përlogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike; dhe
- “**Aplikimi për tarifat e rregulluara**” është një aplikim i dorëzuar nga i licencuari për ZRRE-në për aprovim të tarifave të veta të rregulluara në përputhje me këto udhëzime.

1.3.2 Termat vijues të përdorura në këto Udhëzime do të kenë kuptimin e njëjtë sikur në Rregullën mbi Parimet e Përlogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Metodologjisë së Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe vendimet e nxjerra nga ZRRE-ja sipas këtij Rregulli dhe në përputhje me këtë metodologji:

- “Të ardhurat e lejuara maksimale”;
- “Kontrolli i çmimit”; dhe
- “Periudha e kontrollit të çmimit”.

1.3.3 Termat tjera në këto Udhëzime do të kenë kuptimin si në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, në Ligjin mbi Energjinë ose në Ligjin mbi Energjinë Elektrike.

## 2 Përgatitja dhe dorëzimi i aplikimeve për tarifat e rregulluara

- 2.1.1 **Aplikimet për tarifat e rregulluara** do të përgatiten nga I liçencuari në përputhje me formën e aplikimit për tarifa që e përmban Apendiksi A.1.
- 2.1.2 Aplikacionet do të përmbajnë edhe një informatë shtesë nëse konsiderohet e nevojshme për pajtim me kërkesat nga nenet 8 dhe 10 të Rregullës mbi Çmimet.
- 2.1.3 **Aplikimet për tarifat e rregulluara** do të dorëzohen në formë elektronike dhe në letër nga Shefi Ekzekutiv apo përfaqësuesi i autorizuar nga i liçencuari në pajtim me orarin e përmbajtur në Rregullën mbi Çmimet. Në rast mospërputhjeje, mbetet versioni i formës në letër.
- 2.1.4 Informata do të paraqitet në aplikimin për tarifat e rregulluara në mënyrën më të kuptueshme që mund të bëhet pa sakrifikuar lidhshmërinë apo besueshmërinë.
- 2.1.5 ZRRE-ja do të ketë të drejtën e kërkimit të informatave shtesë nga i liçencuari duke respektuar aplikimin për tarifat e rregulluara në përputhje me Nenin 8.10 të Rregullës mbi Çmimet.
- 2.1.6 ZRRE-ja ka të drejtë kthimi të aplikimeve për tarifat e rregulluara të liçencuarit nëse janë jo të sakta për ri kompletim dhe dorëzim të serishëm. Për qëllime të procedurës që përmbahet në Rregullën mbi Çmimet, kjo do të trajtohet si kërkesë për informata shtesë në përputhje me Nenin 8.10 të Rregullës mbi Çmimet. Duke përcjellë formën e plotë të aplikimit për tarifa të rregulluara, ZRRE-ja do të mbajë të drejtën e kërkimit të informatave shtesë në përputhje me Nenin 8.10 të Rregullës mbi Çmimet.
- 2.1.7 Në përputhje me Nenin 8.2 të Rregullës mbi Çmimet, aplikimet për tarifat e rregulluara do të publikohen nga ZRRE-ja në faqen e saj zyrtare elektronike, me përjashtim të: materialit të identifikuar si material komercialisht i fshehtë (i ndjeshëm) me dorëzimin nga I liçencuari dhe pranuar nga ZRRE-ja si e tillë.

## **A.1 Forma e aplikimit për tarifat e rregulluara**

Një aplikim për tarifa të rregulluara përbëhet nga pesë seksione, shoqëruar me dy tabela raportuese. Përmbajtjet e secilit seksion janë të dhëna më poshtë. Tabelat raportuese janë të dhëna në formë elektronike si faqe exceli MS.

### **A.1.1 Strategjia e tarifës**

Në këtë seksion, të licencuarit sigurojnë:

- Një vlerësim të shtrirjes ku tarifat e rregulluara ekzistuese përputhen me kërkesat e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Metodologjinë e Tarifave dhe, në veçanti, kërkesat për shpenzimet-reflektuese dhe jo-diskriminuese ashtu siç është e vendosur në atë metodologji.
- Një shpjegim se si janë përcaktuar tarifat e rregulluara ekzistuese dhe si lidhen detyrimet përkatëse të kategorive të konsumatorëve individualë me kostot përkatëse të furnizimit të këtyre konsumatorëve.
- Kur tarifat e rregulluara ekzistuese nuk përputhen me kërkesat e Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Metodologjinë e Tarifave, propozimet se si do të ndryshohen tarifat e rregulluara ekzistuese për të mundësuar përputhshmërinë me këto kërkesa, kohëzgjatja për ndryshimet e nevojshme dhe çfarëdo kufizimi apo rreziku i ndërlidhur me implementimin e këtyre ndryshimeve .

### **A.1.2 Të ardhurat e lejuara**

Në këtë seksion, të licencuarit do të sigurojnë:

- Kur janë të rregulluar sipas tarifave të bazuara në performancë, nga i licencuari do të bëhet një llogaritje e të ardhurave të lejuara maksimale në vitin pasues nga tarifat e rregulluara, në përputhje me formulën dhe parametrat relevantë dhe indekset e përcaktuar për këtë qëllim nga ZRRE-ja në vendimin e vet mbi kontrollin relevant të çmimit.
- Kur nuk janë të rregulluar sipas tarifave të bazuara në performancë, të ardhurat e lejuara të propozuara për vitin vijues të cilave do t'iu bashkëngjiten evidencat për shpenzimet e 12 muajve paraprakë dhe parashikimin e shpenzimeve për 12 muajt vijues në formatin e specifikuar nga ZRRE-ja në Udhëzimet Rregulatore për Kontabilitetin dhe arsyetimin mbështetës për çfarëdo ndryshimi në këto shpenzimeve në mes të dy periudhave.

### **A.1.3 Freskimi i tarifave ekzistuese**

Në këtë seksion të licencuarit sigurojnë:

- Një shpjegim se si tarifat e rregulluara ekzistuese do të freskohen në përputhje me të ardhurat e lejuara maksimale për vitin pasues sipas llogaritjes në nënseksionin A.1.2, nën supozimin se nuk janë implementuar ndryshime në strukturën e tarifave ekzistuese.
- Se a do të përshtaten tarifat e rregulluara ekzistuese në përputhje me të ardhurat e lejuara maksimale për vitin pasues në mënyrë jo të njëjtë, si justifikim për dallimet në këto rregullime. Kjo do të ketë lidhje me strategjinë e tarifave dorëzuar nga i licencuari në përputhje me nënseksionin A.1.1.
- Evidencën e sasive të shitura sipas secilës tarifë të rregulluar ekzistuese në dy vitet paraprijëse, ato që pritet të shiten në vitin pasues dhe krahasimin e të ardhurave të parashikuara nga tarifat e rregulluara ekzistuese në vitin pasues me të ardhurat e lejuara maksimale për atë vit.

Duke plotësuar këtë seksion, i licencuari do të përfshijë edhe një tabelë të plotë raportuese të tarifave të rregulluara ekzistuese. Kjo është dhënë ndaras në formë elektronike si faqe Excel Ms.

#### **A.1.4 Amandamentet (ndryshimet ) e propozuara**

Në këtë seksion, të licencuarit sigurojnë:

- Përshkrimin e ndonjë amendamenti të propozuar në strukturën e tarifave të rregulluara ekzistuese, përfshirë shtimin e një kategorie të re konsumatorësh apo fshirjen e kategorisë ekzistuese të konsumatorëve.
- Një përshkrim se si këto amendamente janë në përputhje me strategjinë e tarifave dorëzuar nga i licencuari në përputhje me nënseksionin A.1.1.
- Evidencën për sasi të pritura për t'u shitur sipas çdo tarife të rregulluar ekzistuese të propozuar në vitin pasues dhe një krahasim të të ardhurave të lejuara nga tarifat e rregulluara ekzistuese të propozuara në vitin pasues me të ardhurat e lejuara maksimale.
- Evidencën për sasi të vlerësuara që do të duhej të ishin shitur sipas secilës tarifë të rregulluar ekzistuese të propozuar në dy vitet paraprake, nëse kanë qenë në fuqi në ato vite, dhe një krahasim të të ardhurave të vlerësuara nga tarifat e rregulluara ekzistuese të ndryshuara në këto vite me të ardhurat e lejuara maksimale të aprovuara për këto vite.

Në plotësim të këtij seksioni, i licencuari do të përfshijë edhe një tabelë raportuese të tarifave të ndryshuara. Kjo është dhënë ndaras në formë elektronike si faqe Excel MX.

#### **A.1.5 Këshillim**

Në këtë seksion, të licencuarit do të sigurojnë detaje rreth çdo konsultimi të ndërmarrë me palët e interesuara (akterët) në sektorin e energjisë si pjesë e përgatitjes së tarifave të rregulluara ekzistuese të propozuara. Kjo përfshin:



- Cila informatë është dhënë, dhe si është mundësuar kjo.
- Orarin për publikimin e informatës, dëftesën mbi dorëzimet dhe përgatitja e aplikimit për tarifatat e rregulluara.
- Si janë marrë parasysh çështjet e ngritura nga palët e interesuara në sektorin e energjisë në tarifatat e rregulluara të ndryshuara.

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

---

Anëtarët e Bordit të ZRRE-së

---

---

---

---